

Në bazë të nenit 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit nr.03/L-209 mbi Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.77 / 16 gusht 2010) dhe nenit 1, nenit 20 paragrafit 1, nënparagrafi 1.3 dhe nenit 85 të Ligjit nr.04/L-093 mbi bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.11 / 11 maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 26 mars 2015 miratoi:

## **RREGULLORE PËR KËRKESAT MINIMALE TË SIGURISË**

### **Neni 1**

#### **Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është të përcaktojë kërkesat minimale të sigurisë për hapësirat në të cilat ushtrohen veprimtaritë bankare, me qëllim zhvillimin normal dhe në mënyrë të sigurt të këtyre veprimtarive.
2. Kjo Rregullore aplikohet për të gjitha bankat dhe degët e bankave të huaja të licencuara nga Banka Qendrore për të operuar në Republikën e Kosovës (në vijim: banka).

### **Neni 2**

#### **Përkufizimet**

Të gjithë termat e përdorur në këtë Rregullore kanë kuptim të njëjtë me termat e përcaktuar në nenin 3 të Ligjit nr.04/L-093 për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare (në vijim: *Ligji për bankat*) dhe / ose me përkufizimet në vijim për qëllim të kësaj Rregulloreje :

1. **Sportel** - nënkuptohet ndarja e cila bën të mundur krijimin e një distance sigurie ndërmjet zonës së arkëtarëve dhe zonës së klientëve;
2. **Zona e arkëtarëve** - nënkupton hapësirën e bankës e cila shërben si vendqëndrim i arkëtarëve;
3. **Zona e ruajtjes dhe administrimit të parave të gatshme** - nënkupton zonën, në brendësi të ambienteve të bankës në të cilën vendoset trezori apo kasaforta.

4. **Zona e serverëve** – nënkupton zonën ku ruhen dhe qëndrojnë kryesisht serverët dhe pajisje të tjera ndihmëse, që nevojiten për shërbimet e komunikimit, sinjalizimit dhe pajisje të tjera elektronike ku ruhen shënimet e bankës.
5. **Kushtet për sigurinë** - përfshijnë:
  - 5.1. kushtet për mbrojtjen fizike;
  - 5.2. kushtet për mbrojtjen me personel; si dhe
  - 5.3. kushtet për mbrojtjen elektronike.
6. **Sigurimi i jashtëm** - është shërbimi me personel që kryhet jashtë hapësirës së bankës;
7. **Sigurimi i brendshëm** - është shërbimi me personel që kryhet brenda ambienteve të bankës;
8. **Kompania private e sigurisë (KPS)** - nënkupton personin juridik të licencuar nga Ministria e Punëve të Brendshme për të ofruar shërbime të sigurimit në pajtim me Ligjin nr.04/L-004 për shërbimet private të sigurisë.

### **Neni 3**

#### **Politikat dhe procedurat për kërkesat teknike dhe të sigurisë**

1. Bordi i drejtorëve të bankës miraton politikat për sigurinë dhe kushtet teknike të bankës, ndërsa bordi menaxhues nxjerr procedurat e nevojshme dhe zbaton politikat e bankës.
2. Banka duhet të ketë në strukturën e saj organizative një njësi të veçantë për hartimin, monitorimin dhe zbatimin e procedurave për kushtet teknike dhe të sigurisë.
3. Në degët dhe nëndegët bankare duhet të caktohet së paku një punonjës i bankës, që përveç detyrës që kryen është përgjegjës për zbatimin e procedurave për kushtet teknike dhe të sigurisë.
4. Banka, rishikon në mënyrë periodike, së paku një herë në vit dhe përditëson politikat dhe procedurat për kushtet teknike dhe të sigurisë.

### **Neni 4**

#### **Kërkesa të përgjithshme teknike për ambientet e punës së bankës**

1. Banka ushtron veprimtaritë në ambiente, të cilat plotësojnë së paku kërkesat e mëposhtme:
  - 1.1. Kanë hapësira të nevojshme dhe kushte të përshtatshme të temperaturës, të dritës dhe të lagështirës për punonjësit, klientët për mirëmbajtjen e dokumentacionit dhe të parave të gatshme;
  - 1.2. Kanë pajisjet adekuate kundër zjarrit;

- 1.3. Kanë plan evakuimi në raste emergjence;
  - 1.4. Janë lehtësisht të arritshme nga njësitë e specializuara të sigurisë dhe të mbrojtjes;
  - 1.5. Kanë qartësisht të ndara këto zona:
    - 1.5.1. zona e pritjes së klientit;
    - 1.5.2. zona e arkëtarëve;
    - 1.5.3. zona e ruajtjes së parave të gatshme;
    - 1.5.4. zona e serverëve.
  - 1.6. Janë të pajisura me një burim të dytë dhe të vazhdueshëm të energjisë elektrike.
2. Bankat njoftojnë Stacionin e Policisë në regjionet ku do të hapen degët dhe/ose nëndegët e reja.
  3. Bankat lidhin kontratë me kompaninë private apo institucionet tjera të sigurisë për:
    - 3.1. marrjen dhe verifikimin e sinjalit të alarmit;
    - 3.2. shërbimin e sigurimit;
    - 3.3. transportin e parave të gatshme.

## **Neni 5**

### **Kërkesa për zonën e arkëtarëve**

1. Zona e arkëtarëve të bankave duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme të sigurisë:
  - 1.1. të jetë e vendosur në një ambient të veçantë dhe të ndarë nga zonat e tjera nëpërmjet “Sportelit”;
  - 1.2. të jetë e monitoruar me sistem të kamerave;
  - 1.3. të ketë butona alarmi në secilin vend pune të arkëtarëve; dhe
  - 1.4. të ketë kasaforta ose sirtarë të dedikuar vetëm për mbajtjen e parave të gatshme.

## **Neni 6**

### **Kërkesat për zonën e ruajtjes dhe administrimit të parave të gatshme**

1. Bankat plotësojnë kërkesat e mëposhtme të sigurisë për zonën e ruajtjes dhe administrimit të parave të gatshme:
  - 1.1. të jetë në një vend të sigurt, plotësisht të ndarë dhe të izoluar nga zonat e tjera të bankës;
  - 1.2. të ketë mbrojtje elektronike me:
    - 1.2.1. sensorë sizmikë;
    - 1.2.2. sensorë lëvizjeje;
    - 1.2.3. sensorë tymi.

1.3. të ketë sistem monitorimi me kamera për:

1.3.1. hyrjen për në këtë zonë;

1.3.2. hapësirën e brendshme të kësaj zone.

## **Neni 7**

### **Kërkesat për zonën e serverëve**

1. Zona e serverëve duhet të jetë e veçantë nga zonat e tjera të bankës dhe duhet të vendoset në brendësi të objekteve të bankës.
2. Për të mundësuar ruajtjen e shënimeve dhe vazhdimësinë e biznesit (si back-up) në rast të fatkeqësive apo katastrofave natyrore, bankat duhet të caktojnë edhe një lokacion tjetër rezervë, ku do të vendosen serverët e nevojshëm. Ky lokacion rezervë duhet të vendoset në largësi nga qendra kryesore e bankës, sipas standardeve ndërkombëtare për këtë lëmi.
3. Bankat në zyrën e tyre qendrore dhe në lokacionin rezervë për ruajtjen e shënimeve, duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme të sigurisë për zonën e serverëve:
  - 3.1. të ketë pajisjet e nevojshme për mbajtjen e temperaturës në nivelin e duhur;
  - 3.2. të kenë pajisjet e nevojshme për mbajtjen e lagështisë në nivelin e duhur;
  - 3.3. të ketë mbrojtje elektronike me:
    - 3.3.1. sensorë sizmikë;
    - 3.3.2. sensorë lëvizjeje;
    - 3.3.3. sensorë tymi.
- 3.4. të ketë sistem monitorimi me kamera për:
  - 3.4.1. hyrjen në këtë zonë; dhe
  - 3.4.2. ambientin e brendshëm të kësaj zone.
4. Paragrafi 3 i këtij neni është i aplikueshëm edhe për degët dhe nëndegët e bankave, me përjashtim të nënparagrafit 3.2, i cili mund të aplikohet në ato degë dhe nëndegë për të cilat vlerësohet e nevojshme nga zyrtarët e bankës për mirëmbajtjen e serverëve.

## **Neni 8**

### **Kërkesat për mbrojtjen me anë të pajisjeve elektronike**

1. Bankat marrin masa për mbrojtjen me anë të pajisjeve elektronike të ambienteve në të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre.

2. Bankat për mbrojtjen me anë të pajisjeve elektronike (të vëzhgimit, regjistrimit dhe të tjera) të ambienteve, plotësojnë kushtet e mëposhtme të sigurisë:
  - 2.1. kanë kamera të cilat regjistrojnë në mënyrë të pandërprerë:
    - 2.1.1. sipërfaqet e jashtme të bankës;
    - 2.1.2. hyrjen për në ambientin e brendshëm;
    - 2.1.3. zonën e klientëve;
    - 2.1.4. sportelet; dhe
    - 2.1.5. lokacionet ku janë të vendosura makinat për tërheqjen e parave (ATM), të cilat duhet të mbrohen edhe me pajisjet elektronike shtesë, siç e përcakton banka, varësisht nga vlerësimi i rrezikut për lokacionin përkatës ku është e vendosur ATM-ja.
  - 2.2. kanë pajisje të veçantë digjitale për regjistrimin e pamjeve, e cila:
    - 2.2.1. vendoset në një ambient të sigurt, të ndarë nga zonat e tjera për ruajtjen e parave të gatshme;
    - 2.2.2. koha e ruajtjes së regjistrimeve të jetë jo më pak se 30 (tridhjetë) ditë; dhe
    - 2.2.3. të jetë e mbështetur me pajisje që mundësojnë pamje nga një lokacion tjetër i ndarë.
3. në rastet kur nuk ka pamje të drejtëpërdrejtë nga qendra e monitorimit, monitorimi i zonave të bankës kryhet nga:
  - 3.1. zyra e drejtuesit të tyre; ose
  - 3.2. zyra e përgjegjësit për sigurinë.
4. kanë mbrojtje elektronike me:
  - 4.1. sensorë sizmikë;
  - 4.2. sensorë lëvizjeje;
  - 4.3. sensorë tymi;
  - 4.4. sistem alarmi të montuar në zyrën e drejtuesit të tyre ose në zyrën e punonjësit përgjegjës për sigurinë;
  - 4.5. sirenë alarmi e brendshme;
  - 4.6. sirenë alarmi e jashtme.
5. kanë lidhje direkt për dërgimin e sinjalit të alarmit me:
  - 5.1. Stacionin e Policisë ku ndodhet lokacioni i bankës kur është e realizueshme ose me kompaninë e sigurimit fizik, që i ofron shërbime sigurimi bankës; dhe
  - 5.2. qendrën e monitorimit të bankës.

## **Neni 9**

### **Kërkesat për mbrojtjen me personel**

1. Bankat marrin masa për mbrojtjen me personel të objekteve dhe ambienteve në të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre.
2. Mbrojtja me personel e objekteve dhe ambienteve të bankës përfshin:
  - 2.1. sigurimi i jashtëm në degët dhe nëndegët e bankës, gjatë orarit të punës, duhet të kryhet nga kompanitë private ose institucionet e tjera të sigurisë, i cili vendoset ose jo në varësi të nivelit të rrezikut të perceptuar nga ana e bankës;
  - 2.2. sigurimi i brendshëm në degët kryesore të bankave gjatë orarit të punës, duhet të kryhet nga kompanitë private ose institucionet e tjera të sigurisë ndërsa për nëndegë banka vendos varësisht nga niveli i rrezikut që vlerëson për lokacionin përkatës.
3. Me kërkesë të bankave, Banka Qendrore mund të bëjë përjashtime nga disa kërkesa të parapara në paragrafin 2 të këtij neni për degët dhe nëndegët e bankave.

## **Neni 10**

### **Kërkesat për transportin e parave të gatshme dhe sigurimi i parave të gatshme**

1. Bankat marrin masa për transportimin në mënyrë të sigurt të parave të gatshme;
2. Transporti i parave të gatshme realizohet nga kompania private e sigurisë e pajisur me licencë adekuate.
3. Bankat duhet të posedojnë vazhdimisht policën e sigurimit për sigurimin e parasë së gatshme në trezor dhe paratë e gatshme në lëvizje, me ndonjërin nga kompanitë e sigurimit të licencuara nga BQK-ja.
4. Nëse kompania private e sigurisë që kryen transportin e parave të gatshme të bankave posedon policën e sigurimit adekuate për sigurimin e parasë së gatshme në lëvizje, bankat mund të përjashtohen nga kërkesat e paragrafit 3 të këtij neni, për sigurimin e parasë së gatshme në lëvizje, por në çdo kohë paraja e gatshme në lëvizje duhet të jetë e mbuluar, me policë adekuate të sigurimit të lëshuar nga një kompani e sigurimit e licencuar nga BQK-ja.

## **Neni 11**

### **Përjashtimet nga kërkesat minimale të sigurisë**

1. Pajisjet minimale të sigurisë kërkohen në të gjitha degët dhe nëndegët e bankave. Sistemi i sigurimit për zyrat e tjera të vogla bankare (p.sh dogana, qendrat e kontrollit teknik, qendra të regjistrimit të automjeteve), që punojnë me vlerë të kufizuar të parave të gatshme, do të vendoset nga bankat për secilin rast individualisht, varësisht sesi e vlerëson ekspozimin e këtyre zyrave ndaj rrezikut operacional.
2. BQK-ja në vazhdimësi mund të kërkojë përmbushjen e kërkesave minimale të sigurisë për zyrat e caktuara me paragrafin 1 të këtij neni.

## **Neni 12**

### **Zbatimi, masat përmirësuese dhe dënimet civile**

Çdo shkelje e dispozitave të kësaj Rregulloreje do të jetë subjekt i masave përmirësuese dhe ndëshkuese, siç përcaktohet në Ligjin për Bankën Qendrore dhe Ligjin për bankat.

## **Neni 13**

### **Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Plotësimi i Rregullës së XXVII mbi minimumin e pajisjeve dhe procedurave të sigurimit, e miratuar nga Bordi i BQK-së më 4 prill 2007 dhe çdo dispozitë tjetër, që mund të jetë në kundërshtim me këtë Rregullore.

## **Neni 14**

### **Dispozitat kalimtare**

Bankat duhet të plotësojnë kërkesat e kësaj Rregullore brenda tre (3) muajve nga data e hyrjes në fuqi.

## **Neni 15**

### **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi më datën 1 prill 2015.

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

---

Bedri Peci